



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE

5 qershor 2011

Raporti përfundimtar i Misionit për Vëzhgim të Zgjedhjeve i
OSBE/ODIHR-it



Varshavë
6 tetor 2011

PËRMBAJTJE

| | | |
|-------|--|----|
| I. | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 1 |
| II. | HYRJE DHE MIRËNJOHJE | 3 |
| III. | RRETHANAT POLITIKE | 4 |
| IV. | KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR | 4 |
| A. | KUADRI LIGJOR | 4 |
| B. | SISTEMI ZGJEDHOR | 5 |
| V. | ADMINISTRATA ZGJEDHORE..... | 6 |
| VI. | REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE | 7 |
| VII. | REGJISTRIM I KANDIDATËVE..... | 8 |
| VIII. | FUSHATA ZGJEDHORE | 8 |
| IX. | FINANCIMI I FUSHATËS | 11 |
| X. | MEDIUMET | 13 |
| A. | SHQYRTIM I PËRGJITHSHËM | 13 |
| B. | KUADRI LIGJOR | 13 |
| C. | MONITORIMI MEDIEVE NGA MVZ I OSBE/ODIHR-IT | 14 |
| XI. | PJESËMARRJA E GRAVE..... | 15 |
| XII. | PJESËMARRJA E BASHKËSIVE ETNIKE | 16 |
| XIII. | ANKESAT DHE APELIMET | 17 |
| XIV. | VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE..... | 18 |
| XV. | DITA E ZGJEDHJEVE | 18 |
| XVI. | ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE | 19 |
| XVII. | REKOMANDIME | 20 |
| A. | REKOMANDIME PARËSORE | 20 |
| B. | REKOMANDIME PLOTËSUESE | 21 |
| | SHTOJCA: REZULTATE PËRFUNDMTARE..... | 24 |
| | RRETH OSBE/ODIHR..... | 24 |

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

5 qershor 2011

Raporti përfundimtar i Misionit për Vëzhgim të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it¹

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas marrjes së ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, dhe në bazë të rekomandimit të Misionit të Vlerësimit të Nevojave, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ka vendosur një Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 5 qershorit. Në zgjedhjet u vlerësua respektimi i angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe i legjislacionit vendor. Për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, OSBE/ODIHR-it bashkoi përpjekjet me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe me delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Deklarata për rezultatet dhe konkluzionet paraprake e lëshuar më 6 qershor thotë se “zgjedhjet e parakohshme ishin konkurrense, transparente dhe mirë të administruara mbarë vendit, megjithëse disa aspekte kërkojnë vëmendje të veçantë”. Kjo përfshin masat përkatëse për ndarje të strukturave shtetërore nga ato partiake, kontroll i thelluar i listës zgjedhore, si dhe sqarimin e disa dispozitave të Kodit Zgjedhor. Në ditën e zgjedhjeve, votuesit ishin në gjendje të shprehin lirshëm vullnetin e tyre, përkundër disa akuzave të papërgjegjshme për parregullsi të shprehura nga parti politike.

Megjithëse dispozita të caktuara pësuan ndryshime të konsiderueshme dy muaj para zgjedhjeve dhe pa mbështetjen e opozitës, Kodi Zgjedhor i rishikuar paraqet një bazë të fortë teknike për zgjedhje demokratike, nëse zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Megjithatë, ndryshimi i kuadrit ligjor vetëm pak kohë para zgjedhjeve nuk është në përputhje me praktikën e mirë zgjedhore, sepse ndikon mbi zbatimin në kohë dhe të duhur të ligjit. Kjo u vërejt në mënyrë të veçantë në këto zgjedhje të parakohshme, sepse e shumta e afateve u shkurtuan nga pesë ditë.

Kjo ndikoi në veçantë në votimin jashtë vendit, i cili u zhvillua për herë të parë në këto zgjedhje. Shumë çështje lidhur me procedurat e reja mbetën të pazgjedhura, duke përfshirë edhe mënyrën e votimit të anëtarëve të Këshillit zgjedhor jashtë vendit. Numri i vogël i votuesve që në fund u regjistruan dhe votuan jashtë vendit vuri në dyshim barazinë e votës në vend dhe jashtë.

Komisionet zgjedhore në të gjitha nivelet punuan kryesisht në mënyrë kolegjiale dhe efikase. Seancat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KShZ) ishin të hapura për vëzhguesit e huaj dhe të vendit, si dhe për mediumet. Vendimet për çështje të ndjeshme politike shpeshherë sillleshin sipas përcaktimeve partiake dhe prania e medimeve gjatë seancave të KShZ-së nxiti ndarjet partiake. Megjithëse pati vonesë në arritjen e disa afateve, përgatitjet për zgjedhjet u zhvilluan në kohë. Komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) njoftuan MVZ të OSBE/ODIHR-it se mjetet financiare janë vonuar nga KShZ dhe për këtë arsye disa nga kryetarët e KKZ-ve janë detyruar të përdorin paratë e tyre për të mbështetur funksionimin e KKZ-ve

¹ Këtë raport mund ta gjeni në maqedonisht dhe shqip. Megjithatë, versioni anglisht mbetet dokumenti i vetëm zyrtarë.

Sipas të dhënave, në këto zgjedhje ka pasur rreth 1.82 milion qytetarë me të drejtë vote nga gjithsej 2.05 milion njerëz. Këto shifra nxitën dyshime të vazhdueshme në lidhje me saktësinë e listave zgjedhore. Rekomandimi i kamotshëm i OSBE / ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për një kontroll të plotë të listës zgjedhore mbetet edhe më tej aktual.

Regjistrimi i kandidatëve ishte përfshirës dhe votuesit kishin në dispozicion zgjedhje të gjerë dhe të shumtë të kandidatëve, që përfshinin dy koalicione të gjera, njëra e prirë nga partia në pushtet Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike e Unitetit Nacional Maqedonas (VMRO-DPMNE), dhe tjetra e prirë nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM), si dhe 16 parti të tjera politike.

Liria e shprehjes, lëvizjes dhe tubimit kryesisht u respektua dhe kandidatët patën mundësinë të zhvillojnë fushatën e tyre lirshëm. Zgjedhjet u shpallën në një ambient të bojkotit parlamentar dhe nivelit të lartë të mosbesimit mes partive në pushtet dhe në opozitë, që shpesh rezultoi me një fjalorë nxitës gjatë fushatës. Megjithëse të gjitha partitë politike u angazhuan për zgjedhje demokratike, të lira dhe pa kërcënime, vazhduan akuzat e ndërsjella për frikësime të zgjedhësve dhe shpërdorim të fondeve shtetërore.

Disa parti në mënyrë aktive promovuan veten para fillimit zyrtar të fushatës, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Fushata ishte e qetë dhe mjaft diskrete, në veçanti jashtë Shkupit. Fushata kryesisht u zhvillua në tubime dhe grumbullime të vogla mbarë vendit. Megjithatë, u raportuan disa incidente kryesisht të vogla ku u dëmtuan zyra partiake, disa nga të cilat u ekzagjeruan me qëllim të tërhiqet vëmendja e medimeve.

Gjatë fushatës, pati raste të mos ndarjes të mjaftueshme të aktiviteteve shtetërore nga ato partiake, që është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i viti 1990. Kjo përfshinte shpërdorimin e burimeve shtetërore për fushatë dhe fjalorë partiak kur kandidatët vepronin në cilësi të zyrtarëve shtetërorë. Ky ishte një përjashtim nga cilësia e përgjithshme e procesit zgjedhor.

Si zhvillim pozitiv është përmirësimi i transparencës në financimin e fushatës me kërkesën që partitë të paraqesin një raport të përkohshëm në lidhje me shpenzimet e tyre për fushatën në KShZ, Entin Shtetëror të Revizionit dhe Komisionin Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit (KShNK). E shumta e raporteve u bënë publik që më 27 maj. Megjithatë, dallimet në nivelin e donacioneve të lejuara, padrejtësisht shkaktojnë diskriminim mes individëve dhe subjekteve ligjore, ndërsa aspektet procedurale siç janë formularët e raporteve dhe afatet kanë nevojë për sqarim plotësues.

Një numër i madh i medimeve u ofruan zgjedhësve raportim të llojllojshëm dhe të gjerë duke iu mundësuar të bënin një zgjedhje të informuar. Megjithatë, e shumta përcillnin politika redaktuese partiake, shpesh duke i përzier faktet me komentet redaktueset. Monitorimi i medimeve nga MVZ i OSBE/ODIHR-it tregoi se sasia dhe përmbajtja e mbulimit të fushatës nga televizioni publik ndjeshëm ka favorizuar partitë në pushtet, që është në kundërshtim me detyrimet dhe mandatin e mediumit publik.

Shumë pak ankesa zyrtare u paraqitën në KShZ dhe asnjë në gjykatat. Bashkëbiseduesit justifikuan mungesën e ankesave në gjykata me besimin e ulët në procedurat e ankimit

dhe organet gjyqesore. Madje, Kodi Zgjedhor nuk përshkruan në mënyrë përkatëse procesin e ankesave për mosmarrëveshje zgjedhore.

U respektuan dispozitat e Kodit Zgjedhor për përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve dhe komisionet zgjedhore. Megjithëse dukshmëria e grave gjatë fushatës mbeti e ulët, numri i tyre si kryesuese të listave shënoi rritje.

Partitë politike pothuajse pa përjashtim zhvilluan fushatat në linja etnike, duke pasqyruar kështu polarizimin ekzistues të shoqërisë. Atmosfera në kampin politik shqiptar ishte e qetë, për çka me sa duket ka ndihmuar një marrëveshje mes dy partive më të mëdha të cilat u angazhuan për zgjedhje demokratike.

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve, ishte e qetë dhe paqësore pa ndonjë dallim të theksuar mes mjediseve etnike maqedonase dhe ato shqiptare. U vërejtën vetëm disa parregullsi teknike. KShZ filloi me shpalljen e rezultateve natën pas zgjedhjeve dhe i publikoi në ueb faqe, të klasifikuara sipas njësisë zgjedhore, komunës dhe vendvotimit.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Pas një ftese nga Ministria e Punëve të Jashtme, dhe në përputhje me rekomandimet e Misionit të Vlerësimit të Nevojave realizuar në Shkup nga 05-07 prill 2011, OSBE / ODIHR më 6 maj vendosi një Mision për Vëzhgim të Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 5 qershorit. MVZ-ja u kryesua nga z. Julian Peel Yates dhe përbëhej nga një ekip kryesor 12-anëtarësh me seli në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë nga 16 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së që u vendosën në 10 lokacione në vend. OSBE / ODIHR ka vëzhguar më parë 11 zgjedhje në vend.²

Për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve, OSBE/ODIHR bashkoi përpjekjet me delegacionet nga Asambleja Parlamentare e OSBE (OSBE AP) dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE). Z. Roberto Battelli, Arkëtar i AP OSBE-së dhe shef i delegacionit të AP OSBE-së, u emërua Koordinator Special nga kryesuesi i OSBE-së. Z. Jean-Charles Gardetto kryesoi delegacionin e PACE. Gjithsej, ka pasur 288 vëzhgues afatshkurtër, duke përfshirë 141 vëzhguesit e deleguar nga 41 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Votimi u vëzhguar në rreth 1.200 vende votimi nga gjithsej 2,976. Numërimi u vëzhguar në 114 vendvotime. Procesi i paraqitjes tabelore u vëzhguar në 80 nga 84 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ).

Këto zgjedhje u vlerësuan nga aspekti i respektimit të angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe legjislacionit vendor. Raport përfundimtar vijon pas një deklaratë për rezultatet dhe konkluzionet paraprake që u lëshua në një konferencë shtypi më 6 qershor.³

MVZ i OSBE / ODIHR-it dëshiron të falënderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për bashkëpunimin e tij dhe sigurimin e dokumenteve të akreditimit dhe organeve të tjera shtetërore dhe lokale për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ i OSBE/ODIHR-it

² Të gjitha raportet mund t'i gjeni në ueb faqen e OSBE/ODIHR-it: www.osce.org/odihr/elections/fyrom.

³ Shih <http://www.osce.org/odihr/78439>.

dëshiron gjithashtu t'i shpreh mirënjohje Misionit të OSBE-së në Shkup për bashkëpunimin gjatë misionit si dhe ambasadave në vend të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare.

III. RRETHANAT POLITIKE

Parlamenti miratoi shpërbërjen e tij më 14 prill dhe u shpalli zgjedhjet parlamentare të parakohshme më 5 qershor, zgjedhje të dyta parlamentare të parakohshme të njëpasnjëshme. Zgjedhjet vijuan pas një bojkoti të zgjatur të parlamentit nga ana e partive opozitare, të prira nga LSDM-ja. Bojkoti filloi më 28 janar si përgjigje ndaj ngrirjes së llogarive bankare të katër medimeve si pjesë e një hetimi lidhur me pronarin e *Televizionit A1*, që konsiderohet si mediumi me qëndrime më kritike ndaj pushtetit. Partitë opozitare gjithashtu deklaruan se nuk kishte mundësi për një dialog të vërtetë mes tyre dhe koalicionit mazhoritar të prirë nga Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike e Unitetit Nacional Maqedonas (VMRO-DPMNE).

MVZ i OSBE/ODIHR-it u vendos për zgjedhjet presidenciale dhe vendore më 22 mars dhe 5 prill në vitin 2009. Misioni në raportin përfundimtar thotë se zgjedhjet "kanë plotësuar angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike" megjithëse pati probleme të dukshme, siç ishin akuzat e shumta për frikësim të votuesve.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

A. KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor siguron të drejtat themelore civile dhe politike dhe liritë të nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, nevojiten përmirësime të mëtejshme që ai të jetë plotësisht në pajtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare.

Kodi Zgjedhor (KZ) është ligji kryesor që rregullon zgjedhjet parlamentare. Disa dispozita pësuan ndryshime të konsiderueshme në Prill të vitit 2011 të miratuara nga një shumicë e vogël në parlament, dhe me bojkotim të parlamentit nga ana e partive opozitare.⁴ Megjithëse amendamentet ishin pjesë e një procesi të gjatë konsultativ, në procesin e vendimmarrjes nuk morën pjesë të gjitha partitë politike.⁵

Veç kësaj, ndryshimi i kuadrit ligjor vetëm pak kohë para zgjedhjeve, nuk është në pajtim me praktikën e mira zgjedhore dhe ndikon mbi zbatimin në kohë dhe konzistent të ligjit.⁶ Pasi shumë afate zgjedhore u shkurtuan për pesë ditë për zgjedhjet e parakohshme, u ngrit

⁴ Amendamente të Kodit Zgjedhor u miratuan më 5 prill 2011 (68 nga 120 deputetë). Përveç kësaj, më 13 prill u miratuan ndryshime të kufijve të dy njësisive zgjedhore (63 nga 120 deputetë).

⁵ Shih paragrafin 18.1 të Dokumentit të Moskës i vitit 1991 ku parashihet detyrimi "të miratohen ligjet si rezultat i një procesi të hapur që pasqyron vullnetin e popullit": www.osce.org/odihr/elections/14310.

⁶ Kodi i praktikës së mirë në çështje zgjedhore i miratuar nga Komisionit i Venecias në vitin 2002, II, 2.b.: "Elementet themelore të ligjit zgjedhor...nuk duhet të hapen për ndryshim më pak se një vjet para zgjedhjeve."

pyetja nëse do të arrihej që të bëhen përgatitjet e nevojshme dhe të përcillen informatat përkatëse deri te aktorët zgjedhorë para zgjedhjeve.

Kjo vlente në veçanti për zgjedhjet jashtë vendit që u zhvilluan për herë të parë. Shumë çështje në lidhje me procedurën nuk u trajtuan duke përfshirë edhe atë se si do të japin votën anëtarët e Këshillave zgjedhorë (KZ) jashtë vendit. Më tej, qytetarëve që qëndrojnë jashtë por nuk e plotësojnë kushtin e qëndrimit minimal prej tre muajsh për t'u regjistruar, si dhe atyre që u regjistruan në zyrat diplomatike dhe konsullore ku janë regjistruar më pak se dhjetë votues, në mënyrë efektive u privuan nga e drejta e votës.⁷

Barazia e votës garantohet me Nenin 22 dhe trajtohet edhe me paragrafin 7.3 në Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së në vitin 1990. Megjithatë, numri i vogël i votuesve që u regjistruan për të votuar jashtë vendit shtron çështjen e barazisë së votës brenda dhe jashtë vendit.⁸ Megjithëse, rrethanat e jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe faktorët gjeografik, pranohen si arsye për mosrespektimin e barazisë, devijimet duhet të mbeten minimale. Kodi zgjedhor mundëson 5% devijim mes njërive në vend, por, në kundërshtim me praktikën e mira zgjedhore njësitë zgjedhore jashtë vendit janë përjashtuar nga çdo lloj kushti.⁹

B. SISTEMI ZGJEDHOR

Gjithsej 123 deputet u zgjodhën për një mandat katër vjeçar. 120 deputet u zgjodhën me sistemin proporcional të përfaqësimit nga gjashtë njësi zgjedhore, dhe, për herë të parë, nga një deputet u zgjodh me sistemin mazhoritar nga secila nga tri njësitë jashtë vendit në Evropë, Afrikë, në Amerikën Veriore dhe Jugore, dhe në Australi dhe Azi. Nuk ka prag minimal për zgjedhjen e 120 deputetëve. Por, kandidatët jashtë vendit duhej të fitonin së paku 2 për qind nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në njësinë përkatëse që të marrin mandatin.

Qytetarët, që janë së paku 18 vjeç kanë të drejtë vote, duke përfshirë edhe ata që janë në burg. Çdo qytetar me të drejtë vote mund të paraqitet si kandidat, me përjashtim të atyre që kanë vendim gjyqësor për burgim prej së paku 6 muaj ose vuajnë dënim për kryerjen e ndonjë vepre penale. Kodi Zgjedhor nuk flet për kthimin e të drejtës për kandidim për ata që kanë mbaruar me vuajtjen e dënimit për vepër penale. Me qëllim të respektimit të plotë të paragrafit 7.5 dhe 24 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së nga viti 1990,¹⁰ si dhe

⁷ Kodi zgjedhor Neni 2(17) parasheh që vetëm ata qytetarë të cilët kanë qëndruar së paku tre muaj jashtë bien në grupin e personave që janë në qëndrim të "Përkohshëm jashtë". Sipas Nenit 165(2) të Kodit Zgjedhor, vendvotimi nuk do të vendoset nëse regjistrohen më pak se dy zgjedhës.

⁸ Në njësinë zgjedhore katër (në vend), numri minimal i votave që nevojiten për të fituar një mandat ishte 9,340, ndërsa në njësinë zgjedhore nëntë (jashtë vendit), fituesi morri 548 vota, që paraqet një dallim prej mbi 1,600 për qind.

⁹ Kodi i praktikës së mirë në çështje zgjedhore miratuar nga Komisionit i Venecias në vitin 2002, I, 2.2., thotë: "mandatet duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis njërive zgjedhore... Devijimi i lejueshëm nga norma nuk duhet të jetë më shumë se 10%, dhe kursesi nuk duhet të jetë më i lartë se 15%."

¹⁰ Paragrafi 7.5 i Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990 thotë se vendet pjesëmarrëse "do të respektojnë të drejtën e qytetarëve të garojnë për funksion politik ose publik, individualisht ose si përfaqësues të ndonjë partie politike ose organizate, pa diskriminim". Paragrafi 24 parasheh që "Shtetet pjesëmarrëse të sigurojnë që ushtrimi i të drejtave dhe lirive ... nuk do të jetë objekt i ndonjë kufizimi përveç atyre që i parasheh ligji dhe janë në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, në veçanti Konventa Ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, dhe me angazhimet e tyre ndërkombëtare, në veçanti Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Kufizimet janë në formë të përjashtimeve."

me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, Kodi Zgjedhor duhet të jetë më i qartë rreth asaj nëse dhe kur kthehet kjo e drejtë.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore trepalëshe duke përfshirë KShZ-në, 85 KKZ, 2,976 KZ në vend dhe 36 KZ të vendosura në zyrat diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

KSHZ-ja është organ i përhershëm që emërohet për një mandat katër-vjeçar nga parlamenti. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë dhe mbikëqyr përgatitjet e përgjithshme për zgjedhje. Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë propozohen nga partitë parlamentare të opozitës, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë propozohen nga partitë në pushtet. KSHZ-ja e tanishme është emëruar në vitin 2008.

KShZ ka punuar kryesisht në mënyrë kolegjiale, efikase dhe transparente. Seancat e KShZ-së ishin të hapura për vëzhguesit e huaj dhe të vendit, si dhe për mediumet. KHZ do të përmirësonte transparencën e punës nëse i bënte publike procesverbalet e seancave.¹¹

Disa vendime të rëndësishme, duke përfshirë ato në lidhje me dizajnimin dhe shtypjen e fletëve të votimit dhe akreditimin e disa vëzhguesve, u sollën në grupe punuese të cilat nuk kanë qenë publike dhe ku nuk është votuar. Vendosja për çështje të ndjeshme politike shpeshherë bëhej sipas përcaktimeve partiake dhe prania e mediumeve gjatë seancave të KShZ-së ndikoi mbi zmadhimin e ndarjeve partiake.¹² Disa seanca të KShZ-së që u vëzhguan nga MVZ i OSBE/ODIHR-it dukej sikur ngecnin në detaje të vogla, duke hedhur në hije çështjet kryesore të ditës.¹³ Përkundër disa vonesave në arritjen e afateve lidhur me zgjedhjet, përgatitjet dhe administrim i zgjedhjeve kryesish u zhvillua ashtu si ishte paraparë.¹⁴

KKZ-të janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në çdo komunë. KKZ-të janë organe profesionale me pesë anëtarë (dhe pesë zëvendës), dhe zgjidhen në mënyrë të rastësishme nga radhët e punonjësve në sektorin publik. Të gjithë anëtarët e KKZ-ve sapo ishin emëruar më 26 prill për një mandat pesë-vjeçar. Puna në KKZ-të në përgjithësi u zhvillua në frymë bashkëpunimi dhe vendimet janë marrë në mënyrë konsensuale. Megjithatë, të gjitha KKZ njoftuan MVZ të OSBE / ODIHR-it që financat arritën vonë nga KSHZ-ja, dhe si rezultat i kësaj disa kryetarë të KKZ-ve kanë përdorur paratë e tyre për të mbështetur funksionimin e KKZ-ve

¹¹ Neni 24 i Kodit Zgjedhor parasheh që puna e organeve zgjedhore të jetë publike. Neni 46 i Rregullores për punë të KSHZ-së udhëzon që seancat e KSHZ-së të inçizohen dhe të mbahen procesverbale dhe të futen në arkivat e KSHZ-së. Megjithatë, KSHZ-ja nuk i publikoi procesverbalet nga seancat e veta.

¹² Për shembull: Më 7 dhe 10 maj, gjatë diskutimit të listave të kandidatëve që u dorëzuan, dhe më 16 maj, kur KSHZ-ja votoi në baza partiake për vendimet që mos të hetojë akuzat të bëra nga *Televizioni A1* për frikësim të votuesve.

¹³ Opinion i Komisionit të Venecias nr. 90/2002, 3.1(79) "...rregullorja duhet të parasheh kufizim në kohën e diskutimeve për secilin anëtar, në të kundërtën diskutimet e gjata ka mundësi ta hedhin në hije çështjen kryesore të ditës."

¹⁴ Ndodhën disa shtyrje të afateve në kalendarin e KSHZ-së, siç janë: krijimi i KZ-ve jashtë vendit më 15 maj, jo më 3 maj; zëvendësimet e anëtarëve të KKZ-ve dhe KZ-ve përfundoi më 23 maj, megjithëse afati ishte 6 maj.

KZ-të janë përgjegjëse për secilin vendvotim para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve. KZ-të janë të përbërë nga një kryetar, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, duke përdorur një model të përzier profesional-politik. Një anëtar propozohet nga partitë qeverisëse, një nga partitë opozitare, dhe tre anëtarë janë rastësisht të zgjedhur nga radhët e punonjësve të administratës publike, për një periudhë katër-vjeçare.

KSHZ krijoi një program trajnimi të detyrueshëm për të gjitha komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët. KSHZ trajnoi KKZ-të dhe KKZ-të trajnuan KZ-të. KSHZ gjithashtu trajnoi KZ-të për vendvotimet jashtë vendit. Trajnimi i vëzhguar nga MVZ i OSBE / ODIHR-it mund të përmirësohej me përdorimin e teknikave ndërvepruese të trajnimit.

KSHZ miratoi dhe botoi dy doracakë për trajnim, një për KKZ-të dhe një tjetër për KZ-të. KSHZ-ja konsideronte këto doracakë si një zëvendësim për aktet ligjore për punën e KKZ-ve dhe KZ-ve dhe për këtë arsye lëshoi disa akte për të rregulluar detyrat e dhëna me Kodin Zgjedhor.

Disa vendime u miratuan nga KSHZ-ja në çastin e fundit, por këto masa nuk u zbatuan në tërësi dhe krijuan konfuzion në nivelet më të ulëta të komisioneve zgjedhore. Kjo veçanërisht vlente për një vendim mbi atë se çfarë përbënte një fletëvotimi i pavlefshëm, i cili ishte në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.¹⁵ Mungesa dhe përdorimi kontradiktor i rregulloreve është në kundërshtim me praktikën e mirë zgjedhore, e cila bën thirrje që organet e administratës zgjedhore të lëshojnë udhëzime me sqarim të mëtjshëm apo detaje të dispozitave ekzistuese ligjore dhe të bazohet drejtpërdrejt në dispozitat e legjislacionit zgjedhor.

KSHZ zhvilloi një program të shkurtër edukimi për votuesit dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve të përbërë nga xhirime televizive, fletushka, dhe udhëzime për votim që të nxisë votuesit për të marrë pjesë, duke shpjeguar procesin e votimit, dhe duke tërhequr vërejtjen kundër shkeljeve zgjedhore. MVZ i OSBE / ODIHR-i shtroi çështjen e një mangësie të programit për edukimin të votuesve, që u shtrua nga disa bashkëbisedues, dhe kishte të bëjë me mungesën e informatës për procedurat për paraqitjen dhe zgjidhjen e ankesave.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Përgjegjësinë e azhurnimit dhe mirëmbajtjes së listave zgjedhore, për herë të parë e pati KShZ-ja. Verifikimi publik i ekstrakteve të listës zgjedhore u zhvillua prej 25 prill deri më 4 maj. Ekstraktet e listës zgjedhore ishin në dispozicion për verifikim në zyrat rajonale dhe lokale të KShZ-së,¹⁶ përmes një programi internet për kërkim, dhe duke dërguar e-mail deri te zyra përkatëse e KShZ-së.¹⁷ KShZ njoftoi më 15 maj se lista zgjedhore

¹⁵ Sipas Kodit Zgjedhor një fletë votimi është e vlefshme nëse qartë tregon vullnetin e votuesit. Megjithatë, në udhëzimet e KSHZ-së thuhet se nëse në fletëvotim ka ndonjë shenjë, simbol, ose shënim tjetër me përjashtim të rrethit, atëherë fleta e votimit duhet të shpallet e pavlefshme.

¹⁶ Këto 34 zyra rajonale më parë janë menaxhuar nga Ministri i Drejtësisë, por u transferuan në KSHZ pasi e mori përgjegjësinë e regjistrimit të zgjedhësve.

¹⁷ Sipas të dhënave të KShZ-së, 18,662 njerëz kanë verifikuar të dhënat e tyre gjatë kësaj periudhe, nga të cilët 42 njerëz janë regjistruar për herë të parë, 842 të vdekur janë fshirë *ex officio*, janë kërkuar 210 ndryshime të të dhënave personale nga qytetarët, dhe 24 njerëz që kanë kërkuar të regjistrohen, janë refuzuar.

përfundimtare për këto zgjedhje përmban 1,821,122 zgjedhës, diku 29,000 më shumë se në zgjedhjet presidenciale dhe vendore në vitin 2009.

Gjithsej 7.213 persona janë regjistruar për të votuar jashtë vendit; 4591 në njësinë zgjedhore 7 i cili mbulon Evropën dhe Afrikën, 1824 në njësinë e tetë zgjedhore e përfshinë Amerikën Veriore dhe Jugore, dhe 798 në njësinë e tetë zgjedhore e cila mbulon Australinë dhe Azinë. Numri i vogël i votuesve të cilët janë regjistruar jashtë, nxjerri në pah shqetësimet në lidhje me barazinë mes votave në vend dhe jashtë.

Shqetësimet në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e listave të votuesve u shprehën nga shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE / ODIHR-it dhe ato janë të kamotshme. Me një popullatë prej 2,050,671 mbetet shqetësimi se numri i zgjedhësve në listën zgjedhore është i fryrë.¹⁸

Sipas KSHZ-së, ka diku 80.000 njerëz që punojnë ose qëndrojnë jashtë vendit dhe që vazhdojnë të shfaqen në listat zgjedhore, me një yll pranë emrit të tyre. Megjithatë, ky numër besohet se paraqet vetëm një pjesë të atyre që janë jashtë vendit, duke rikonfirmuar aktualitetin e rekomandimeve të mëparshme të OSBE / ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias për shqyrtim të plotë të listave zgjedhore.¹⁹

VII. REGJISTRIM I KANDIDATËVE

Në zgjedhjet parlamentare mund të marrin pjesë kandidatë të emëruar nga partitë politike, koalicionet e partive politike, ose nga kandidatë të pavarur të emëruar nga grupe zgjedhësish. Gjithsej, 1,679 kandidatë morën pjesë në këto zgjedhje, duke u ofruar kështu zgjedhësve një laramani opsionesh politike. Dy koalicionet e gjera, njëri i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe njëri nga LSDM, si dhe 16 parti politike paraqitën lista të kandidatëve dhe garuan në këto zgjedhje. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përfshin 22 parti dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM përfshin 15 parti. Të dy koalicionet në radhët e tyre kanë edhe parti nga bashkësitë e vogla etnike. Të gjitha partitë shqiptare dolën në zgjedhje vetë, duke përfshirë edhe Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) dhe Partin Demokratike Shqiptare (PDSH). Listat e kandidatëve që u paraqitën nga një parti dhe nga grup qytetarësh nuk i plotësuan kushtet dhe me të drejtë nuk u regjistruan nga KShZ-ja.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Megjithëse zgjedhjet ndodhën në kushte të bojkotimit parlamentar dhe në mesin e një mosbesimi të ndjeshëm mes partive opozitare dhe atyre në pushtet, atmosfera e përgjithshme gjatë fushatës ishte e qetë dhe diskrete, në veçanti jashtë Shkupit.

E shumta e kandidatëve përdorën fjalor neutral dhe ftuan mbështetësit e tyre të sillen në mënyrë të qetë dhe t'i shmangen dhunës; megjithatë, pati disa raste të fjalorit nxitës.²⁰ Kjo

¹⁸ Numri i popullatës sipas Entit Shtetëror Statistikor më 31 dhjetor 2009, www.stat.gov.mk.

¹⁹ Rezultatet e regjistrimit në tetor pritet që të qartësojnë gjendjen.

²⁰ MVZ i OSBE-ODIHR-it vëzhguan folësit e Bashkimit Demokratik Shqiptare (BDSH) në Tetovë, liderin e PDSH-së z. Menduh Taçi në Debreshtë dhe liderin e partisë të Bashkuar për Maqedoninë (BM) në Manastir të përdorin fjalor nxitës duke sulmuar qeverinë aktuale.

qe veçanërisht e theksuar mes liderëve të dy koalicioneve, të cilët vazhduan të shkëmbejnë akuza për veprime të paligjshme dhe sulme personale, duke nxitur kështu interesin e medimeve dhe duke hedhur në hije fushatat e partive të tjera.

Disa parti në mënyrë aktive promovuan veten para 16 majit, kur ishte paraparë fillimi zyrtar i fushatës 19-ditore. Fushata e parakohshme u paraqit edhe në formë të reklamave që zinin dy faqe në disa gazeta, lidhje në faqet e internetit të gazetave që çonin në faqet e drejt video filmimeve të fushatave të lëshuara në internet, dhe shpërndarje të materialeve të fushatës. Në Shkup u shfaqën bilborde ku shkruante "A jeni për fitore", me një "po" të rrethuar²¹ dhe bilborde të tjera në mbështetje të partive të caktuara politike. Disa bashkëbisedues shprehën mendimin e tyre se fushata e parakohshme ishte rezultat i fushatës së shkurtër dhe i përkufizimit të gjerë që i jep Kodi Zgjedhor fjalës "fushatë".

Fushata kryesisht u zhvillua në mitingje dhe tubime të vogla në të gjithë vendin.²² Ndërsa VMRO-DPMNE ka përdorur shumë bilborde dhe afishe, garuesit e tjerë në zgjedhje janë grumbulluar në ngjarje të vogla, fushatë derë më derë, dhe mediumet shoqërore, për shkak të mungesës së burimeve financiare.²³ Partitë gjithashtu kanë promovuar edhe ueb faqet e tyre si një mjet për t'u siguruar qytetarëve informacione për kandidatët e partisë dhe platformat e tyre.

Partitë kishin mundësi lirshëm të zhvillojnë fushatën, dhe në përgjithësi u respektua liria e lëvizjes, shprehjes. Përfundimisht ishte refuzimi i kryetarit të komunës Qendër të Shkupit të lejojë mbajtjen e një tubimi të planifikuar nga LSDM-ja në qendër të qytetit më 19 maj. Në disa komuna në vend, partitë paraqitën kërkesë për leje për të organizuar takime publike deri te zyrat e kryetarëve të komunave, edhe pse Kodi Zgjedhor kërkon që vetëm të dërgohet një njoftim deri te zyra rajonale e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB).²⁴

Çështje ndëretnike ishin shumë pak të pranishme gjatë fushatës zgjedhore, sepse partitë zhvilluan fushatat e tyre pothuajse ekskluzivisht përgjatë linjave etnike. Ndërsa çështjet me interes të përbashkët siç janë zhvillimi ekonomik, BE dhe NATO, dhe emri i vendit u gjetën në platformat e partive më të mëdha, ato u trajtuan sipas interesave të bashkësive etnike.

Pjesëmarrësit në zgjedhje në nivel lokal shpeshherë bashkëpunuan në mënyrë konstruktive dhe treguan respekt ndaj njëri tjetrit. Ka shembuj të marrëveshjeve rreth dhënies së hapësirave të lira për afishe dhe bashkërenditje të orareve të tubimeve, si dhe ndeshjeve të futbollit mes aktivistëve të BDI-së dhe PDSH-së në Likovë dhe volejboll ku ishin të pranishëm aktivistë nga Tetova. Ambienti në kampin politik shqiptar ishte kryesisht i qetë, për të cilin duket se ka ndihmuar marrëveshja mes BDI-së dhe PDSH-së për zgjedhje të qeta dhe demokratike.

²¹ Asnjë parti politike nuk morri përgjegjësinë për bilbordet që u shfaqën një ditë para zgjedhjeve në të cilat rrinte "A jeni për fitore". Megjithatë, Kryesisht konsiderohej se ato janë të VMRO-DPMNE-së.

²² MVZ e OSBE-ODIHR-it vëzhguan 73 tubime mbarë vendit.

²³ Kjo gjithashtu pasqyrohet në raportin për financimin e fushatës të partive. VMRO-DPMNE deklaroi shpenzime për fushatën në vlerë prej 272 milion denarë ndërsa LSDM-ja shpenzoi 17.5 milion denarë.

²⁴ Kjo praktikë u raportua në Shkup, Shtip, Ohër dhe Tetovë.

Kushti që komunat të caktojnë vend të lirë për ngjitjen e afisheve nuk u zbatua në mënyrë konzistente. Pati disa incidente të shkatërrimit të afisheve dhe bilbordave. Në të shumtën e komunave, sasi të mëdha afishesh që i takonin VMRO-DPMNE-së u vërejtën në vende të palejuara.

Për disa incidente kryesisht të vogla ku u dëmtuan zyra partiake, u njoftua MVZ i OSBE/ODIHR-it dhe Ministria për Punë të Brendshme (MPB). MPB informoi për 28 raste të dëmtimit të zyrave zgjedhore.²⁵ Disa parti për incidentet e njoftuan vetëm MVZ të OSBE/ODIHR-it, përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar dhe vëzhguesit nga vendi por jo autoritetet. Madje, shumë akuza të pabaza të shpërdorimeve zgjedhore u bënë nga partitë politike gjatë ditës së zgjedhjeve. Kur u bënë përpjekje për t'i vërtetuar ato, MVZ i OSBE/ODIHR-it zbuloi se incidentet e raportuara ishin shpesh të egzagjeruara ose të rrejshme.

Ndryshe nga ambienti i qetë në të gjithë vendin, si afrohej dita e zgjedhjeve ashtu u rritën tensionet në komunën Shuto Orizare, kryesisht e banuar me Romë. Më 25 maj, shpërthyen përlëshje midis përkrahësve të dy partive kryesore romë, URM e cila në zgjedhje kishte dalë në koalicion me VMRO-DPMNE-në, dhe PCER, në koalicion me LSDM-në. Tensionet u shkallëzuan natën e zgjedhjeve kur kryetar i komunës që ishte nga radhët e URM-së, së bashku me bashkëpunëtorë, kinse kishte sulmuar fizikisht udhëheqësin e PCER-it.²⁶

Gjatë fushatës ka pasur raste të ndarjes të pamjaftueshme mes shtetit dhe strukturave partiake, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990²⁷. Kjo u pa në veprimet e disa zyrtarëve të qeverisë, sidomos ata që njëkohësisht ishin kandidatë në zgjedhje. Veprimet e tilla devijuan nga cilësia e përgjithshme e procesit zgjedhor.

MVZ e OSBE/ODIHR-it u njoftuan me akuzat se aktivistë partiak kishin kërkuar nga nëpunës shtetërorë të japin një numër të caktuar të votuesve të cilët do të votonin për partinë në pushtet. Sipas këtyre akuzave, nëpunësit në institucionet shtetërore dhe publike janë frikësuar dhe kërcënuar se do të humbin vendin e punës nëse nuk e plotësojnë këtë kërkesë. Akuza të tjera kishin të bëjnë me kërcënime se qytetarët do të humbin pensionet e tyre ose ndihmën sociale nëse mbështesin ose nuk mbështesin partinë ose kandidatë të caktuar. E shumta e këtyre akuzave ishin në lidhje me veprime të zyrtarëve shtetërorë dhe aktivistëve të partisë në pushtet. Çdo aktivitet partiak nga nëpunës shtetërorë gjatë orarit të punës paraqet shpërdorim të burimeve shtetërore për qëllime partiake.

MVZ të OSBE/ODIHR-së iu dorëzuan e-maile ku shihet se aktivistë partiak të VMRO-DPMNE-se u kanë dërguar kërkesa kryetarëve të komunave dhe drejtuesve të institucioneve arsimore para shpalljes të zgjedhjeve. MVZ gjithashtu hasën në kopje të listave të hartuara nga nëpunës të institucioneve arsimore dhe bibliotekës shtetërore.

²⁵ Xhamat e zyrave partiake të VMRO-DPMNE-së, LSDM-së, BDI-së, BM-së, Partisë për Emancipimin e Potë të Romëve (PCER) dhe Unionit të Romëve në Maqedoni (URM) u thyen në Manastir, Kavadar, Kërçovë, Kumanovë, Radovish, Prilep, Shkup dhe Tetovë.

²⁶ Gjendja u qetësua pas zgjedhjeve pasi që të dy liderët e partive fituan mandate në parlament. MPB-ja zhvillon hetim zyrtar lidhur me akuzat për sulm.

²⁷ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së nga viti 1990 parasheh “ndarje të qartë mes Shtetit dhe partisë politike”.

Zyra e Avokatit Popullor njoftoi se ka pranuar shtatë ankesa nga qytetarë që janë detyruar të bënin lista të tilla në periudhën parazgjedhore, dhe tre ankesa të tjera në lidhje me frikësime nga parti politike në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, në raportin përfundimtar të lëshuar më 16 qershor, zyra e Avokatit Popullor, thekson se e shumta e rasteve nuk kishin baza për veprim të mëtejshëm, duke pasur parasysh se ishin anonime.

Më 19 maj, Kryeministri, duke mos bërë dallimin mes funksionit të tij si Kryeministër dhe lider i partisë politike, lëshoi një letër në memorandum të qeverisë deri te të gjithë nëpunësit shtetëror dhe nëpunës të qeverisë ku apelon që ata të "garantojnë zgjedhje të lira." Por, në letrën e njëjtë, Kryeministri morri qëndrim partiak kur flet për "sulme nga kundërshtarët tanë politik" dhe "sulme të pabaza nga opozita."

Pati raste ku Ministri i punëve të brendshme, që gjithashtu ishte kandidat udhëheqës i VMRO-DPMNE-së, përdori autoritetin e funksionit të saj në favor të fushatës, që shkaktoi konflikt interesash mes detyrave të saj si udhëheqëse e MPB-së dhe aktiviteteve të saj si kandidat. Në një rast, Ministria ia dorëzoi KSHZ-së, dosjet penale të disa përfaqësuesve të autorizuar të LSDM-së që duhej të vëzhgonin në ditën e zgjedhjeve, me kërkesë që mos të akreditohen, megjithëse nuk ekzistonte bazë ligjore për një gjë të tillë. Veç kësaj, më 2 qershor, duke komentuar sulmin mbi veturën e kandidatit kryesor të LSDM-së, Ministria vuri në pyetje motivet dhe besueshmërinë e deklaratave nga dëshmitarët para përfundimit të hetimit.

Akuza të mëtejshme për shpërdorim të funksionit të MPB-së në interes të zgjedhjeve u paraqitën te MVZ i OSBE/ODIHR-së në lidhje me disa polic Shqiptarë etnik në rrethinën e Kumanovës të cilët janë ulur në pozitë për shkak të mungesës së lojalitetit të tyre ndaj BDI-së dhe shkarkimin e dy oficerëve të policisë vetëm disa javë para zgjedhjeve.²⁸

Neni 9 i Kodit Zgjedhor parasheh që "zyrtarët e lartë" të Ministrisë së Brendshme dhe Mbrotjtjes të pezullojnë përkohësisht detyrat e tyre zyrtare pasi të jenë verifikuar si kandidatë. Ky nen është paraparë që të parandalojë konflikte të interesave që janë të natyrshëm kur dikush ka një rol të dyfishtë si zyrtar në një ministri kyçe dhe kandidat gjatë periudhës zgjedhore. Kur kjo çështje u shtrua në bisedë me VMRO-DPMNE-në, ata u pajtuan se Ministrat ishin "zyrtarë të autorizuar" sipas nenit 9; por, interpretimi i tyre ishte se neni nuk kishte të bëjë me ministrat, sepse sipas Ligjit për nëpunës shtetërorë dhe Ligjit për punë, ata janë anëtarë të qeverisë dhe jo të punësuar të ministrive të tyre përkatëse.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor në prill të vitit 2011, u përmirësua dukshëm transparenca e financimit të fushatës. Kjo ka të bëjë me detyrimin që partitë të paraqesin një raport të përkohshëm në lidhje me shpenzimet e tyre për fushatën në KShZ, Entin Shtetëror të Revizionit dhe Komisionin Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit (KShNK). Megjithatë, kjo dispozitë nuk parasheh që këto raporte të shqyrtohen para ditë së zgjedhjeve.

Pjesëmarrësit në zgjedhje mund të financojnë fushatat e tyre nga kuotat e anëtarësimit ose donacionet. Limiti ligjor për donacione nga individ privat është 5,000 euro, ndërsa limiti për personat juridik është 5% nga të ardhurat e tyre nga viti i kaluar, me çka duket se u

²⁸

Shefi i policisë në Rostushë, Mavrovi-Anovi, si the Shefi i policisë rrugore në Gostivar.

jepet një avantazh subjekteve më të mëdha. Asnjë donacion nuk mund të merret nga burime të huaja ose publike. Të gjitha partitë kanë për detyrë të hapin llogari bankare të posaçme për donacione dhe shpenzime lidhur me fushatën, që është burimi i vetëm i financimit të aktiviteteve zgjedhore. Ka edhe limit të shpenzimeve të përgjithshme për fushatë prej 180 denarë për zgjedhës, ose gjithsej 327.8 milion denarë (5.4 milion euro).

Nga pjesëmarrësit në zgjedhje u kërkua të paraqesin dy raporte financiare të përkohshme për të ardhurat dhe shpenzimet, një më 27 maj dhe i dyti më 4 qershor, si dhe raportin përfundimtar më 19 qershor. Të gjitha partitë dorëzuan raportin e parë brenda afatit. Por, katër parti nuk e dorëzuan raportin e dytë në afatin e duhur.²⁹ Më 9 qershor, KSHNK ngriti padi për kundërvajtje kundër këtyre partive, që mund të rezultojë me gjoba nga 4000 deri 5000 euro. Më 24 qershor, e njëjta procedurë u ngrit kundër katër partive që nuk dorëzuan raportin përfundimtar.³⁰ Më parë, BDSH-së iu tërhoq vërejtja në lidhje me mos transferimin e dallimit mes vlerës së lejuar dhe vlerës së vërtetë të donacionit në buxhetin shtetëror, ashtu si e kërkon Kodi Zgjedhor.

Megjithëse nuk ka afat për të verifikuar raportet e dorëzuara para ditës së zgjedhjeve, e shumta e raporteve u bënë publike në kohë,³¹ dhe e shumta e garuesve në zgjedhje i respektuan dispozitat e Kodit Zgjedhor. KSHNK lëshoi shpejt mendim në lidhje me raportin e parë dhe të dytë dhe kërkoi nga pjesëmarrësit në zgjedhje të qartësojnë raportet e tyre në rastet kur shpenzimet ishin më të mëdha se të hyrat.³² Veç kësaj, KSHNK, e ngriti çështjen nëse huan që LSDM-ja e kishte marrë nga banka mund të cilësohej si financim i fushatës pasi Kodi Zgjedhor parasheh që fushatat të financohen me kuota anëtarësie ose donacione. U paraqitën gjithashtu edhe mospërputhje mes raportit të dorëzuar nga LSDM dhe të dhënat që u dorëzuan nga Këshilli radiodifuziv për reklamat politike.

Në raportin përfundimtar, KSHNK shprehu vlerësim pozitiv për pjesëmarrësit në zgjedhje që kishin dorëzuar raportet në kohë dhe i rikujtoi ata që nuk e kishin bërë ta kryejnë detyrën e tyre. Gjithashtu u dha rekomandimi për ngritje të padis penale kundër LSDM-së dhe *A1 Televizionit* për mospërputhjet në raportet e tyre, të cilat, nëse dëshmohej do të paraqesin shkelje të rregulloreve për financimin e fushatës që mund të rezultojë me ndëshkim maksimal me 5 vjet burg.

Në pajtim me rekomandimet e kaluara të OSBE/ODIHR, Kodi Zgjedhor tani parasheh kthim të pjesshëm të shpenzimeve për fushatën për kandidatët e pazgjedhur të cilët kanë fituar së paku 1.5% të votave.

²⁹ Bashkimi Demokratik Kombëtar (BDK), Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), Partia Social Demokratike e Maqedonisë (PSDM), dhe BM.

³⁰ Partia Liberal Demokratike (PLD), BDK, PPD, dhe PSDM.

³¹ Raportet u shpallën në internet me vonesë minimale. Megjithatë, përkundër detyrimit ligjor, asnjë raport nuk u publikua në ueb faqen e Zyrës Shtetërore për Revizion.

³² BDI paraqiti të ardhura prej 4,251,000 denarë dhe shpenzime prej 7,316,920 denarë; PDSH paraqiti të ardhura prej 669,000 denarë dhe shpenzime prej 2,735,368 denarë; Partia për Demokratët e Bashkuar në Maqedoni (PODEM) paraqitën të ardhura prej 79,000 denarë dhe shpenzime prej 121,000 denarë; Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE paraqiti të ardhura prej 31,930,000 denarë dhe shpenzime prej 272,256,168 denarë.

X. MEDIUMET

A. SHQYRTIM I PËRGJITHSHËM

Numër i madh i medimeve u ofruan zgjedhësve raportim të llojllojshëm dhe të gjerë duke iu mundësuar të bënin një zgjedhje të informuar.³³ Televizioni mbetet i vetmi burim i informacioneve politike. Megjithatë, e shumta e medimeve përcillnin politika redaktuese partiake dhe iu mungonte analizë dhe vlerësim kritik, shpesh duke i përzier faktet me komentet redaktuese.

Shërbimi publik i radiodifuzionit, radioja maqedonase dhe televizioni (MRT), përbëhet prej tre kanaleve televizive me mbulesë nacionale, një kanal satelitor, dhe tre stacione nacionale të radios. MRT financohet nga taksa e radiodifuzionit për amvisëritë dhe subjektet juridike

Megjithëse medimet private kanë një nivel të caktuar të lirisë, pronarët shpesh luajnë rolin kryesor në politikën redaktuese të partizuar të tyre. E shumta e televizioneve private të nivelit nacional janë pronë e familjarëve të liderëve të partive politike të përfaqësuara në parlament, në kundërshtim me Ligjin për veprimtari radiodifuzive.³⁴

Qeveria mbetet reklamuesi më i madh në vend. Përderisa reklamat që paguhën nga buxheti shtetëror ose ai komunal ndalohen pas shpalljes së zgjedhjeve, disa nga bashkëbiseduesit e OSBE/ODIHR-it dhënie e reklamave qeveritare e shohin si shpërblim për politikën redaktuese besnike.

Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-it shprehën rezervat e tyre në lidhje me ngrirjen e llogarive bankare të *Televizionit A1* dhe tri gazetave të përditshme, *Vreme*, *Shpic dhe Koha e Re*, si pjesë e një hetimi lidhur me pronarin e *Televizionit A1*. Këto medime konsiderohen si më kritiket ndaj politikave qeveritare dhe për këtë arsye për shumë njerëz këto hetime janë të ngarkuara me motive politike. Përfaqësuesi i Zyrës së OSBE-së për Lirinë e Medimeve tërhoqi vërejtjen e autoritetet shtetërore se asnjë hetim që ka të bëjë me shmangien e tatimeve ose shpëlarjen e parave nuk duhet të ndikojë mbi punën e *Televizionit A1* ose botimin e gazetave të përditshme.³⁵ Mundësia për ndalesa të mëtejshme ndaj këtij televizioni mbeti një temë e vazhdueshme e fushatës.

B. KUADRI LIGJOR

Mbulimi i fushatës zgjedhore rregullohet me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për veprimtari radiodifuzive, si dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli i radiodifuzionit, organi rregullator i radiodifuzionit. Më 21 prill, Këshilli i radiodifuzionit miratoi një rregullore për sjellje të medimeve gjatë fushatës dhe, për herë të parë në këto zgjedhje, u përfshi edhe periudha nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin zyrtar të fushatës. Kuadri ligjor

³³ Medimet përfshijnë 14 televizione nacionale, 12 satelitore dhe 132 radio stacione rajonale, si dhe 10 gazeta ditore.

³⁴ Neni 11 i Ligjit për veprimtari radiodifuzive thotë: “Partitë politike, ... bartësit e funksioneve dhe pjesëtarët e familjeve të tyre nuk mund të zhvillojnë veprimtari radiodifuzive ose të paraqiten si themelues ose bashkëthemelues të operatorëve radiodifuziv, ose të marrin pronësinë e operatorit radiodifuziv.”

³⁵ Raporti i rregullit të Këshillit të përhershëm nga znj. Dunja Mijatović, Përfaqësuese e OSBE-së për lirinë e medimeve, 17 Mars 2011: <http://www.osce.org/fom/76158>. Ky qëndrim u rikonfirmua në njoftimin për shtyp me 4 korrik: <http://www.osce.org/fom/80636>.

kërkon që mediumet të mbulojnë fushatën në mënyrë të drejtë, të barabartë, dhe në mënyrë të paanshme. Ata gjithashtu kanë për detyrë kandidatëve t'u ofrojnë qasje të barabartë. Mbulimi i kandidatëve zgjedhorë është proporcional me numrin e njësive zgjedhore ku është kandiduar pjesëmarrësi në zgjedhje.³⁶

Nuk lejohet që mbulimi i aktiviteteve të qeverisë gjatë lajmeve të përdoret për të favorizuar ndonjë nga kandidatët. Në periudhën prej shpalljes së zgjedhjeve dhe fillimit të suksesshëm të fushatës, mediumet mund të mbulojnë aktivitetet e fushatës dhe kandidatët gjatë lajmeve. Duke reaguar ndaj kritikave të medimeve se kushtet e tilla kufizojnë lirinë redaktuese, Këshilli i radiodifuzionit u dha medimeve të drejtën të mbulojnë zgjedhjet në programet e aktualiteteve me kusht mos të marrin pjesë kandidatët e regjistruar nga KShZ-ja.

Kodi Zgjedhor parasheh që kohëzgjatja e reklamave politike me pagesë në mediumet komerciale duhet të kufizohet në 15 minuta në orë, me maksimum 10 minuta për një kandidat të vetëm. Mediumet publike nuk kanë të drejtë të emitojnë reklama politike me pagesë.

Këshilli i radiodifuzionit mbikëqyr respektimin e legjislacionit dhe rregulloreve zgjedhore nga ana e medimeve dhe ka të drejtë të ngre padi për kundërvajtje dhe të vendos gjopa për shkelje të kryera nga ndonjë medium. Gjatë periudhës të fushatës zgjedhore zyrtare, Këshilli i radiodifuzionit ka monitoruar 15 medime. Megjithëse arritën të zbulojnë shkeljet në mënyrë të shpejtë, nuk arritën të reagojnë në kohë. Vendimet e para kundër shkeljeve u sollën 5 ditë para zgjedhjeve, ndërsa e shumta e proceseve për kundërvajtje u iniciuan pas zgjedhjeve.

Në përgjithësi, Këshilli i radiodifuzionit ngriti gjithsej 39 padi për kundërvajtje kundër 5 radiodifuzerëve kombëtarë, 4 satelitorë dhe 11 rajonal kryesisht për shkelje në lidhje me reklama me pagesë, sondazhe të opinionit publik, dhe për mosrespektim të periudhës të heshtjes zgjedhore. Nëntë procese u ngritën kundër disa medimeve, kryesisht nacionale, për mbulim të pa balancuar të fushatës, dhe nëntë kundër medimeve rajonale për emetimin e reklamave politike pa shpallur publikisht çmimin para fillimit të fushatës.

C. MONITORIMI MEDIEVE NGA MVZ I OSBE/ODIHR-IT

MVZ i OSBE/ODIHR-së zhvilloi monitorimin e medimeve prej 9 maj deri më 3 qershor. Misioni monitoroi shtatë kanale televizive dhe pesë gazeta.³⁷

Shërbimi publik i radiodifuzionit *MTV-1* respektoi detyrimin ligjor për t'u dhënë kohë falas partive politike dhe 13 parti shfrytëzuan këtë mundësi. *MTV-1* dhe *MTV-2* krijuan një program special i quajtur "Kronika e zgjedhjeve", për të mbuluar aktivitete zgjedhore të garuesve. Por, koha falas dhe "Kronika e zgjedhjeve" zakonisht transmetoheshin jashtë kohës me shikueshmëri të lartë, duke kufizuar kështu publikun potencial. Partive shqiptare etnike iu lejua kohë plotësuese pa pagesë në *MTV-2*.

³⁶ Shih Nenin 6 të "Rregullores për qasje të barabartë në paraqitjen në media gjatë fushatës zgjedhore."

³⁷ Kanale televizive të monitoruara: *MTV-1*, *MTV-2*, *A1*, *Kanal 5*, *Sitel*, *Alsat-M*, dhe *Telma*. Gazeta të monitoruara: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Vreme*, *Koha*, dhe *Lajm*.

Rezultatet nga monitorimi i zhvilluar nga MVZ i OSBE/ODIHR-it treguan anshmëri të theksuar nga aspekti i sasisë dhe përmbajtjes të mediumet e monitoruara. Në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe mandatin publik që e ka, mbulimi i fushatës nga *MTV-1* favorizonte qeverinë dhe fuqimisht kritikonte opozitën.³⁸ Ndërsa koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE i jepej diku 20 për qind nga mbulimi kryesisht pozitiv dhe neutral, koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja kishte 19 për qind të mbulimit, kryesisht me ton negativ. Ndërsa fjalimet e bartësve të listave të VMRO-DPMNE-së shpeshherë emitoheshin, fjalimet e përfaqësuesve të LSDM-së u emituan katër herë më pak.

MTV-2 i kushtoi 19 për qind të mbulimit partisë qeverisëse BDI dhe rreth 23 për qind zyrtarëve qeveritarë, ndërsa PDSH dhe DR morën vetëm 7 dhe 8 për qind. Toni i përgjithshëm i mbulimit ishte shumë më i balancuar, në krahasim me *MTV-1*.

MTV-1 dhe *MTV-2* u dhanë 35 dhe 23 për qind, respektivisht, zyrtarëve qeveritarë. Raportimi shpesh nuk bënte dallimin mes rolit të tyre si kandidatë dhe si zyrtarë qeveritarë.³⁹

Al Televizion, kanali televizivë më i popullarizuar, i kushtoi 20 për qind të mbulimit kryesisht neutral LSDM-së, dhe 30 për qind të mbulimit tejet kritik partisë qeverisëse. Nga ana tjetër, kanalet private *Sitel* dhe *Kanal 5* i kushtuan 38 respektivisht 32 për qind, të mbulimit kryesisht pozitiv koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, ndërsa koalicionit të udhëhequr nga LSDM iu dha 32 respektivisht 29 për qind, të mbulimit pothuajse në tërësi negativ. *TV Telma* adoptoi një qëndrim më të balancuar, megjithëse mbulimi ishte kryesisht kritik ndaj koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Mbulimi i *Alsat-M* i aktorëve kryesorë në zgjedhje ishte kryesisht neutral.

Përkundër planit fillestar, *MTV-1* nuk organizoi debate zgjedhore. Megjithatë, *MTV-2* organizoi 5 debate mes partive etnike shqiptare. Disa kanale televizive private gjithashtu mbajtën debate mes partive politike. VMRO-DPMNE vendosi mos të merrte pjesë në asnjë debat gjatë fushatës zgjedhore.

Mediet e shtypura prezantuan pikëpamje të llojllojshme. Megjithëse *Dnevnik* dhe *Nova Makedonija* kryesisht dhanë një fotografi të balancuar të fushatës, ata mbajtën një qëndrim më kritik ndaj koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Nga ana tjetër, *Vreme* mbante qëndrim shumë kritik ndaj koalicionit qeveritar. Tendencë e ngjashme u vërejt edhe në mediumet në gjuhën shqipe. *Koha* u përqendrua në aktivitetet e BDI-së, partisë në pushtet, dhe fuqimisht kritikonte Demokracinë e Re (DR), Lajmi, nga ana tjetër, kishte qëndrim kritik ndaj aktiviteteve qeveritare dhe BDI-së.

XI. PJSËMARRJA E GRAVE

Megjithëse dukshmëria e grave në këto zgjedhje ishte më e vogël se ajo e burrave, gratë luajtën një rol më të rëndësishëm se në zgjedhjet e kaluara si kandidatë, aktiviste politike, pjesëmarrëse në fushatë, dhe në administratën zgjedhore.

³⁸ Nenin 6 i “Rregullores për qasje të barabartë në paraqitjen në media gjatë fushatë zgjedhore (Rregullore për mediumet); Neni 75(5) i Kodit Zgjedhor; Ligji për veprimtari radiodifuzive Neni 80.

³⁹ Ashtu si parasheh Neni 15 i Rregullores për mediumet.

Sipas Kodit Zgjedhor, një nga tre vendet në listat e kandidatëve duhet të rezervohen për gjininë më pak të përfaqësuar që të sigurohet përfaqësimi i të dy gjinive në të gjitha listat. Të gjitha listat e kandidatëve e plotësuan këtë kusht. Nga 1,679 kandidatë për deputet, 566 ishin gra (33.7 për qind). Në krahasim me zgjedhjet e kaluara parlamentare, kishte një rritje të numrit të grave si bartëse të listave nga 6 në vitin 2008 në 15 në vitin 2011. Në fund, 36 gra u zgjodhën deputete, në krahasim me 42 në vitin 2008. Kjo paraqet një rënie nga 35 % në 29% të grave deputete.

Gratë ishin të pranishme edhe në komisionet zgjedhore dhe u plotësua pragu prej 30 për qind që e parasheh Kodi Zgjedhor. Në 84 KKZ rreth gjysma e anëtarëve ishin gra dhe 40 për qind janë kryesuar nga gra. Vëzhgimi gjatë ditës së zgjedhjeve tregoi se 47 për qind i KZ-ve u kryesuan nga gra. I vetmi përjashtim ishte KShZ-ja, ku vetëm një nga shtatë anëtarët është grua.

Çështjet gjinore nuk luajtën rol të rëndësishëm gjatë fushatës, megjithëse e shumta e partive politike i kishin përfshirë ato në platformat zgjedhore. Disa parti zhvilluan aktivitete edukative për votuesit që kishin për qëllim pikërisht votueset gra.

Votimi familjar shënoi një rënie të vogël në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2008, prej 18 në 15 për qind të njësive zgjedhore të vëzhguara. Megjithatë, numri i rasteve mbeti i lartë, me 173 raste të observuar në ditën e zgjedhjeve. KShZ-ja ka ndërmarrë hapa për të adresuar votimin familjar përmes krijimit të "Strategjisë kundër votimit familjar" që u miratua në dhjetor të vitit 2010.

XII. PJESËMARRJA E BASHKËSIVE ETNIKE

Çështjet e etnike janë të pranishme në pothuajse të gjitha agjendat. Prioritetet e dy bashkësive etnike më të mëdha – Maqedonas dhe Shqiptarë – mbizotëruan gjatë fushatës, dhe ata garonin kryesisht brenda bashkësive të tyre etnike.

Me pjesëmarrje prej gjithsej 10 për qind të popullatës, bashkësitë e tjera zyrtarisht të njohura – Turqit, Serbët, Romët, Vllahët, dhe Boshnjakët – kryesisht promovuan çështje të rëndësishme për ta përmes partive etnike që ishin pjesë e dy koalicioneve kryesore. Megjithëse këto parti etnike iu bashkëngjitën platformave të përbashkëta të koalicioneve, ata zhvilluan fushatën në bazë të agjendave të tyre etnike me qëllim që të sigurojnë mbështetje nga grupi etnik përkatës dhe rrisin shanset e tyre për të hyrë në parlament. Partitë më të vogla etnike fituan 11 mandate në parlament si pjesë e koalicioneve zgjedhore.

Partitë etnike shqiptare u përqendruan në ripërcaktimin e statusit të bashkësisë së tyre në vend, dhe fituan 25 mandate në këto zgjedhje, që shënoi një rënie prej 4 mandate në krahasim me rezultatet e vitit 2008. Kjo ishte kryesisht rezultat i daljes së ulët në njësinë zgjedhore 6 në pjesën perëndimore të vendit dhe faktit se shtatë parti dolën në zgjedhje vetë, duke përfshirë DR-në dhe Rilindjen Demokratike Kombëtare, që për herë të parë morën pjesë në zgjedhje parlamentare.

Megjithëse MPB ndërmori masa për të siguruar dokumente identifikimi para ditës së zgjedhjeve, ato nuk kishin për qëllim bashkësitë e vogla etnike, veçanërisht Romët, për të cilët mungesa e dokumenteve të identifikimit ka qenë një pengese e vjetër për

pjesëmarrjen e tyre. Kodi Zgjedhor parasheh “përfaqësim të drejt dhe adekuat të bashkësive etnike në organet zgjedhore.” Në nivel lokal kjo ka të bëjë me bashkësitë të cilat përbëjnë së paku 20 për qind të popullatës në komunën përkatëse. Ky parim kryesisht u pasqyrua në përbërjen e KKZ-ve dhe KZ-ve. Për KZ-të, lihej të kuptohet se ky parim, megjithëse i rregulluar me ligj, zbatohet vetëm te anëtarët e KZ-ve që i takojnë administratës publike, dhe jo atyre të emëruar nga partitë.

Në përgjithësi, zbatimi i këtij parimi në KZ-të varet nga përfaqësimi i bashkësive etnike në administratën publike, i cili për disa grup mbetet i ulët. Në disa raste, zbatimi i pragut prej 20 për qind ka përfshirë bashkësitë etnike, përqindja e të cilëve është pak nën pragun.⁴⁰

XIII. ANKESAT DHE APELIMET

Kuadri ligjor për ankesa dhe apele për zgjedhjet parlamentar mbrohet drejtat zgjedhore. Ankesat lidhur me emërimin e kandidatëve, të drejtën e votimit, dhe procedurat në ditën e zgjedhjeve duhet të paraqiten në KShZ, vendimet e të cilit mund të ankimohen para Gjykatës administrative. Ankesat lidhur me fushatën paraqiten në gjykatat themelore, dhe këto vendim mund të ankimohen para Gjykatës së apelit.

Përkundër këtyre mundësive të ndryshme ligjore, asnjë ankesë nuk u paraqit në gjykatat dhe vetëm tre u paraqitën në KShZ para ditës së zgjedhjeve. Bashkëbiseduesit e MVZ i OSBE/ODIHR-it arsyetuan mungesën e ankesave zyrtare me mungesën e besimit në procedurat e organeve gjykuese.

KShZ nuk e përcaktoi dhe nuk e rregulloi saktësisht procesin e ankimimit, që rezultoi me veprime të papërshtatshme dhe të vonuara gjatë periudhës parazgjedhore. Nga tre ankesat zyrtare, vetëm dy u shqyrtuan në seancë. KSHZ hodhi poshtë njëren ankesë duke rekomanduar padi për kundërvajtje për botim sondazhit jashtë afateve ligjore, ndërsa ankesa e paraqitur nga LSDM-ja për dëmtimin e afisheve u la pa vendim për shkak të ndarjes së votave. Ankesa e paraqitur nga LSDM-ja ku akuzon VMRO-DPMNE-në për fillim të parakohshëm të fushatës asnjëherë nuk u shqyrtua publikisht.

Në disa raste, ankesat janë paraqitur në institucion të gabuar. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak të leximit të ngushtë të kompetencave të organeve për ankesa dhe apele dhe kuptimi i gabuar i sistemit zgjedhor nga garuesit në zgjedhje. Disa gjykatës në gjykatat themelore i kanë thënë MVZ të OSBE/ODIHR-së se ata nuk ishin të njoftuar me rolin e tyre në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve gjatë fushatës.⁴¹

Më tej, Kodi Zgjedhor nuk përshkruan në mënyrë të duhur procesin e ankimimit për konteste zgjedhore. Sipas Kodit zgjedhor, ankesat e tyre duhet të paraqiten në gjykatat themelore. Por, dispozitat e vetme që kandidatëve u japin të drejtën të paraqesin ankesa vetëm në rastet kur një kandidat “dhunon dhe trazon fushatën e kundërshtarit,” duke kufizuar kështu të drejtën e ankesës për lloje të tjera të shkeljeve lidhur me fushatën.

Më 11 maj, Prokurori publik ngriti një hetim në lidhje me akuzat për frikësim të votuesve nga partia qeverisëse VMRO-DPMNE, në lidhje me listat e votuesve që do të votonin për

⁴⁰ Për shembull në Komunën e Dollnenit, në njësinë zgjedhore 5, ku bashkësia turke paraqet afërsisht 19 për qind të popullatës lokale sipas regjistrimit të vitit 2002.

⁴¹ Gjykatat themelore në Manastir, Shkup, Shtip dhe Veles.

ta.⁴² Më 25 maj rreth 20 nëpunës shtetërorë që ishin në lista u thirrën të japin dëshmi. E shumte e tyre nuk u paraqitën në bisedë, ata që u paraqitën mohuan se kishin pasur presion që të votonin për VMRO-DPMNE, sipas Prokurorit publik. Në bazë të këtyre intervistave Prokurori Publik, më 3 qershor, tha se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vazhduar procesin. Një hetim tjetër nga një prokuror lokal në Manastir, u hodh poshtë më 19 maj pas zhvillimit të dy bisedave duke konkluduar se nuk kishte prova të mjaftueshme për të vazhduar.

XIV. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

KZ parashih praninë e vëzhguesve lokal dhe ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Këto zgjedhje i kanë vëzhguar 493 vëzhgues ndërkombëtarë nga organizata ndërkombëtare dhe ambasada, dhe 7,358 vëzhgues nga vendi që janë akredituar nga KSHZ. Grupi më i madh i vëzhguesve ishte ai i organizatës MOST me 4,467 vëzhgues të akredituar, me 1,123 gjithashtu të dërguar nga Shoqata humanitare SINERGIJA, 937 nga Arsimi Plus Maqedonia, dhe 550 nga Iniciativa rinore për dialog dhe bashkëpunim – MIDS.

Vëzhguesit lokal ishin të pranishëm në 83 për qind të vendotimeve që u vizituan nga vëzhguesit. Më tej, garuesit zgjedhorë vendosën përfaqësues të autorizuar për të vëzhguar në ditën e zgjedhjeve dhe ishin të pranishëm në 96 për qind të vendotimeve të vizituara nga vëzhguesit. Ndërsa përfaqësuesit e autorizuar të partive mund të merrnin kopje të procesverbaleve me rezultatet, vëzhguesit vendorë morën vetëm pjesën tabelore. Në 42% të njëjësive zgjedhore të vëzhguara, KZ-të nuk i shpallën publikisht procesverbalet e rezultateve.⁴³

XV. DITA E ZGJEDHJEVE

Në ditën e zgjedhjeve, MVZ i OSBE/ODIHR-it dhe delegacioni i AP OSBE dhe APKE vëzhguan hapjen, votimin dhe numërimin në rreth 1200 vendvotime mbarë vendit. Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte e qetë, përkundër disa deklaratave të papërgjegjshme nga partitë politike. Nga të dhënat zyrtare të KShZ-së mësohet se dalja në zgjedhje ka qenë 63.5 %.

Votimi i parakohshëm u zhvillua më 4 qershor për zgjedhësit që nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre, të burgosurit, personat e zhvendosur në vend (PZhV), dhe votuesit jashtë vendit. Vlerësimi i përgjithshëm ishte pozitiv në 54 nga 55 rastet e vëzhguara mbarë vendit. Pati disa probleme me disa të burgosur që nuk ishin në listën zgjedhore dhe raste ku fshehtësia e votimit nuk u respektua në rastet e votimit të personave që nuk mund të dalin nga shtëpia.

Vëzhguesit ndërkombëtarë vlerësuan hapjen e vendotimeve pozitivisht në 114 prej 116 vendvotimeve të vizituara. Vëzhguesit vërejtën se 26 vendvotime të vëzhguara nuk u

⁴² *Televizioni Al* raportoi se VMRO-DPMNE u kishte dhënë urdhër udhëheqësve të sektorëve në institucionet e shtetit të dorëzojnë lista me së paku 15 persona të cilët do të jepnin mbështetjen e tyre për partinë dhe si kompensim do të fitonin vend pune ose përfitime të tjera.

⁴³ Neni 118(3) i Kodit Zgjedhor parashih që rezultatet të shpallen publikisht në vendvotim.

hapën në kohë. Megjithatë, vonesat e konstatuara nuk zgjatën dhe nuk cenuan të drejtën e votuesve.

Procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 97 për qind të vendvotimeve pa ndonjë dallim të theksuar mes vendbanimeve maqedonase dhe ato etnike shqiptare. Puna e KZ-ve u vlerësua si e mirë ose shumë e mirë në 94 për qind të vendvotimeve dhe njohja që ata kishin për procedurën e votimit u vlerësua pozitivisht në 94 për qind të vëzhgimeve. Hapësirat e votimit u vlerësuan si të papërshtatshme dhe të stërmbushura me njerëz në një nga njëzet vëzhgime.

Parregullsitë procedurale të vërejtura gjatë procesit të votimit janë: 115 raste të problemeve me fshehtësinë e votës (10 për qind), kryesisht për shkak të renditjes së vendvotimit; 38 raste të kutive të votimit të mbyllura në mënyrë të gabuar (3 për qind); dhe 173 raste të votimit familjar (15 për qind).

Numërimi i votave u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 100 nga 114 KZ të vëzhguar. Megjithëse u vërejtën disa gabime procedurale gjatë numërimit, kjo duket se nuk pati ndonjë ndikim mbi vlerësimin e procesit në tërësi. Në 42 vende ku u vëzhgua numërimi, kopjet e procesverbaleve zyrtare nuk u shpallën publikisht. Paraqitja tabelore e votave u zbatua në 80 nga 84 KKZ dhe u vlerësua si e mirë ose shumë e mirë në 98% të vëzhgimeve. Megjithëse u vërejtën mospërputhje në disa nga protokollat e KZ-ve, të gjitha u zgjodhën në mënyrë të duhur. Në përgjithësi, paraqitja tabelore dukej të jetë mirë e organizuar dhe transparente, dhe anëtarët e KKZ-ve njihnin mirë procedurën.

Në drejtim pozitiv, vëzhguesit vërejtën se në shumë raste KKZ-të dhe KZ-të ndërmorën hapa proaktiv për të parandaluar parregullsitë dhe adresuan problemet potenciale në çastin që ato ndodhnin.

KShZ filloi t'i shpallë rezultatet natën e zgjedhjeve dhe i shpalli në ueb faqen e saj të klasifikuara sipas njësisë zgjedhore, komunës dhe vendvotimit. Rezultatet përfundimtare u shpallën nga KShZ më 14 qershor.

XVI. ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Në ditën e zgjedhjeve u paraqitën gjithsej 16 ankesa në KShZ në lidhje me parregullsi dhe me paraqitjen e rezultateve. Në disa kërkohej anulimi i rezultateve në disa vendvotime. KShZ i shqyrtoi të gjitha ankesat më 9 qershor në seancë të hapur dhe vendimet u morën në afatin e duhur. Përfaqësues partiak ishin të pranishëm dhe patën mundësinë të japin shpjegim në lidhje me ankesat e paraqitura.

Ankesa e paraqitur nga PODEM u pranua dhe KShZ-ja urdhëroi KKZ-në të shtojë 18 vota që mungonin në favor të partisë në vendvotimet 33 dhe 80 në Manastir, por kjo nuk ndikoi rezultatet në tërësi. KShZ hodhi poshtë të gjitha ankesat si të pabaza. Ankesat e paraqitura nga BM u hodhën poshtë sepse në procesverbalin e KZ-së dhe KKZ-së përkatëse nuk kishte asnjë shënim që tregon se partia ishte ankuar në KZ. Megjithëse ligji parasheh të bëhen vërejtje në procesverbalin e KZ-së ose KKZ-ve në rastin e ndonjë dyshimi për parregullsi, kjo nuk është parakusht që partia të mundet të paraqes ankesë në KShZ. Rastet e akuzave për fotografim të fletëvotimit të shënuar u përcollën në MPB për hetim të mëtejshëm.

Pesë vendime të KShZ-së u apelian në Gjykatën administrative, një nga DR-ja dhe katër nga BM-ja. Gjykata konfirmoi vendimin e KShZ-së në pesë rastet. Seancat ishin publike dhe nuk pati paraqitje të dëshmimeve të reja për të mbështetur ndonjë nga rastet. Të gjitha vendimet u shpallën publikisht dhe u paraqitën në ueb faqen e Gjykatës administrative dhe KShZ-së në kohën e duhur.

Dy zhvillime post zgjedhore nxitën shqetësime të bashkëbiseduesit. Natën e zgjedhjeve, gjatë festimit zyrtar të VMRO-DPMNE-së në qendrën e Shkupit një djalë i ri u vra, dhe për këtë vrasje u dyshua një pjesëtar i policisë speciale. Dy ditë më radhë, MPB mohoi se ishte kryer krimi, dhe në fund pranoi vrasjen dhe përgjegjësinë e pjesëtarit të njësitit special të policisë. Pas kësaj pati disa protesta ditore kundër MPB-së dhe brutalitetit policor në përgjithësi. Në kohën e shkrimit të raportit, vazhdonte hetimi në lidhje me këtë rast.

Një ditë pas zgjedhjeve, lideri i BM-së, z. Boshkoski, u arrestua me akuzë për financim të paligjshëm të fushatës dhe shpërdorim të detyrës.⁴⁴ Arrestimi i tij në qendër të Shkupit nga policë të njësitit special me maska u filmua dhe u postua në internet përmes kanalit YouTube të MPB-së. Disa bashkëbisedues shtruan çështjen e tajmingut të këtij arrestimi.

XVII. REKOMANDIME

OSBE/ODIHR jep këto rekomandime që të shqyrtohen nga autoritetet, partitë politike, dhe shoqëria civile në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e tjera të dhëna nga OSBE/ODIHR më parë. OSBE/ODIHR mbetet i gatshëm të ndihmojë autoritetet në përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor.

A. REKOMANDIME PARËSORE

1. Autoritetet duhet të marrin në konsideratë krijimin e garancive për të siguruar ndarjen mes shtetit dhe partisë siç parashihet paragrafi 5.4. i Dokumentit të OSBE-së nga Kopenhaga i vitit 1990. Garancitë ekzistuese ligjore, siç është neni 9 i Kodit Zgjedhor duhet të interpretohen si mënyrë për të parandaluar konfliktet e interesave mes qëndrimit të qeverisë që duhet të jetë i pavarur dhe ato të kandidatëve që ndjekin avantazhin politik. Këto dispozita mund të përfshijnë edhe mekanizma të zbatimit.
2. Vëmendje duhet t'i kushtohet tejkalimit të mangësive dhe paqartësive të Kodit Zgjedhor të cilat janë zbuluar gjatë procesit zgjedhor, veçanërisht ato që përmenden në mënyrë specifike në këto rekomandime. Për këtë qëllim, duhet të vendoset një proces përfshirës konsultativ shumë kohë para zgjedhjeve të ardhshme.
3. Që moti ekziston nevoja për një auditim dhe revidim të listave zgjedhësve. Kjo duhet të bëhet pas regjistrimit të tetorit në vitin 2011. Gjatë kësaj duhet të kontrollohen njerëzit që kanë vdekur ose ata që jetojnë jashtë.

⁴⁴ Neni 165-a dhe 353 i Kodit Penal

4. Duhet të zhvillohet hetim i shpejt, i thelluar dhe efektiv në lidhje me akuzat për frikësim të votuesve dhe fajtorët të ndiqen. Qytetarët duhet të nxiten që të denoncojnë rastet që mbështeten mbi dëshmi të besueshme.
5. Duhet të ndërmerren hapa për të zgjedhur konfliktet e interesave në lidhje me kontrollin e shërbimeve private të radiodifuzionit nga ata që janë të angazhuar në politikë. Kjo praktikë është në kundërshtim me ligjin dhe pengon mbulimin e balancuar politik gjatë fushatës zgjedhore.
6. Duhet të vendosen afate më të shkurtra për gjykatat për shqyrtimin e ankesave që janë paraqitur kundër shërbimeve radiodifuzive nga Këshilli i radiodifuzionit para dhe gjatë fushatës. Kjo do t'i mundësoj Këshillit të radiodifuzionit të zbatojë rregulloret me kohë dhe do t'u jep mundësi shërbimeve të radiodifuzionit të reagojnë shpejtë dhe në mënyrë efektive nëse u janë shkelur të drejtat.

B. REKOMANDIME PLOTËSUESE

Kuadri ligjor

7. Autoritetet duhet të ndryshojnë sistemin aktual të dhënies së mandateve në njësitë zgjedhore jashtë vendit dhe të sigurojnë që numri i votuesve që nevojitet për të zgjedhur deputetët mos të zvogëlojë dukshëm barazinë e votës, ashtu si e garanton Kodi Zgjedhor.
8. Duhet të sigurohet e drejta e votës për anëtarët e KZ-ve jashtë vendit dhe për qytetarët e regjistruar që qëndrojnë më pak se tre muaj jashtë vendit.
9. Kodi Zgjedhor duhet qartë të parasheh që e drejta e votës t'u kthehet personave të dënuar me burg për më shumë se gjashtë muaj pasi ata të kenë shërbyer dënimin e tyre.

Administrimi i zgjedhjeve

10. Një administrim efektiv i zgjedhjeve të ardhshme do të varej shumë nga adoptimi me kohë dhe gjithëpërfshirës i rregulloreve për të menaxhuar procesin zgjedhor dhe për të përmirësuar mangësitë e Kodit Zgjedhor.
11. Për të përmirësuar transparencën, procesverbalet nga seancat e KShZ-së mund të bëhen publike.

Regjistrimi i votuesve

12. Informata që përshkruajnë procedurat e regjistrimit për qytetarët jashtë vendit duhet të publikohen shumë kohë para zgjedhjeve.

Fushata zgjedhore

13. Rregulloret e fushatës duhet të respektohen dhe zbatohen në tërësi. Autoritetet duhet të marrin parasysh ndryshimin e rregulloreve të cilat shumë parti i konsiderojnë tepër restriktive, siç është ajo për kufizimin e fushatës, përcaktimin e aktiviteteve gjatë fushatës, dhe përcaktimin e vendit ku mund të vendosen afishet.

14. Fushatat e arsimimit të votuesve, qoftë ato që zhvillohen nga autoritet, shoqëria civile, ose partitë politike, duhet të përqendrohen në fshehtësinë e votës si mjeti kryesor për të luftuar frikësimet dhe presionet mbi votuesit që pengojnë lirinë e zgjedhjes. Votuesit duhet të nxiten të kërkojnë që të respektohet fshehtësia e votës së tyre.

Financimi i fushatës

15. Dispozitat në lidhje me financimin e fushatës duhet të parashohin dhe mekanizma më efektiv të auditimit. Duhet gjithashtu të merret parasysh adoptimi i një formulari më të detajuar për raportet ku nga pjesëmarrësit në zgjedhje do të kërkohej të japin të gjitha shpenzimet në mënyrë të detajuar.
16. Duhet të vendosen afate për auditimin e raporteve financiare para ditës së zgjedhjeve. Institucionet përgjegjëse duhet të përforcojnë kapacitetet e tyre që të mundësojnë një auditim në kohë dhe të saktë.
17. Dallimet që paraqiten mes pragjeve për donacione nga individ dhe nga persona ligjor duhet të rishqyrtohen. Dispozitat ekzistuese janë diskriminuese dhe u japin një avantazh të padrejtë subjekteve të mëdha.

Mediet

18. Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit të radiodifuzionit, duhet t'i jepet përparësi profesionalizimit dhe paanshmërisë të kandidatëve të mundshëm, dhe jo përkatësisë së tyre politike. Kjo vlen akoma më shumë pas ndryshimit të Ligjit për radiodifuzion, më 18 korrik, me çka numri i anëtarëve të Këshillit u rrit nga 9 në 15.
19. Që të ruaj pavarësinë e vetë thelbësore, Këshilli i radiodifuzionit ka nevojë për mbështetje financiare të parapërcaktuar dhe të përshtatshme.
20. Rregulla të hollësishme për mbulimin e fushatës për mediumet, mund të përfshihen në Ligjin për radiodifuzion dhe në Kodin Zgjedhor, në vend që të miratohen për çdo zgjedhje.
21. Pavarësia e shërbimit radiodifuziv publik mund të përforcohet duke siguruar financimin përkatës.

Pjesëmarrja e grave

22. Autoritetet duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje praktikës së votimit familjar, që është veçanërisht e pranishme në bashkësitë etnike më të vogla. Duhet të kërkohej mënyra për të eliminuar këtë dukuri dhe të kërkohej zbatimi i përpiktë të nenit 112 të Kodit Zgjedhor.

Vëzhgimi i zgjedhjeve

23. Kodi Zgjedhor dhe rregulloret e zgjedhjeve duhet të përcaktojnë qartë se vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë kanë të drejtë të marrin kopje të gjitha procesverbaleve të KZ-ve dhe KKZ-ve, dhe jo vetëm pjesën tabelore.

24. KSHZ dhe KKZ duhet të zbatojnë kërkesën që KZ-të të shpallin publikisht kopjet e procesverbaleve me rezultatet, menjëherë pas përfundimit të numërimit.

Ankesa dhe Apelime

25. Procedurat të ankesave dhe apelimit duhet të thjeshtësohen dhe të bëhen gjerësisht publike, KShZ-ja duhet të miratojë procedura të hollësishme për mënyrën e paraqitjes dhe zgjidhjes së ankesave që të sigurohet zbatim konzistent dhe efektiv i Kodit Zgjedhor.
26. Duhet të konsiderohet heqja e kufizimit në Nenin 73 të Kodit Zgjedhor që pjesëmarrësve në zgjedhje u jep vetëm mundësinë e ankesës kundër veprimeve të ndërmarra nga kundërshtari në zgjedhje.
27. Neni 31(2)(35) i Kodit Zgjedhor, që iu jep mandatin KSHZ-së për të inspektuar materialin votues në bazë të ankesës, vetëm në raste kur së paku dy ankesa janë paraqitur për vendvotimin përkatës, duhet të hiqet sepse shkel të drejtën për mjete efektive ligjore. Nuk duhet të ketë prag për numrin e ankesave që duhet të paraqiten që ato të shqyrtohen.
28. Neni 105 i Kodit Zgjedhor duhet të qartësohet dhe të thotë qartë nëse kushti për të paraqitur ankesë në ditën e zgjedhjeve deri te KSHZ-ja është që ajo të jetë përmendur paraprakisht në procesverbalin e KZ-së ose KKZ-së përkatëse.

SHTOJCA: REZULTATE PËRFUNDMTARE

| Nr. | Partia/koalicioni | Votat e fituara | % | Mandatet |
|-----|--|-----------------|-------|----------|
| 1. | Demokracia e Re – DR | 19,958 | 1.78 | 0 |
| 2. | Partia për Demokratët e Bashkuar në Maqedoni – PODEM | 4,395 | 0.39 | 0 |
| 3. | Bashkimi Social Demokrat – SDU | 2,270 | 0.20 | 0 |
| 4. | Bashkimi Demokratik i Shqiptarëve– BDSH | 4,517 | 0.40 | 0 |
| 5. | Koalicioni i VMRO-DPMNE-së | 438,138 | 38.98 | 56 |
| 6. | VMRO - Partia Popullore – VMRO-NP | 28,217 | 2.51 | 0 |
| 7. | Bashkimi Demokratik për Integrim – BDI | 115,092 | 10.24 | 15 |
| 8. | Partia Demokratike Shqiptare – PDSh | 66,315 | 5.90 | 8 |
| 9. | Partia Politike Dostoinstvo – PPD | 8,837 | 0.79 | 0 |
| 10. | Koalicioni i LSDM-së | 368,496 | 32.78 | 42 |
| 11. | Bashkimi Demokratik Kombëtar – BDK | 470 | 0.04 | 0 |
| 12. | Partia Liberal Demokrate – PLD | 16,551 | 1.47 | 0 |
| 13. | Partia Social Demokrate e Maqedonisë – PSDM | 1,807 | 0.16 | 0 |
| 14. | E Djathta Demokratike | 1,517 | 0.13 | 0 |
| 15. | Partia Evropiane e Maqedonisë | 130 | 0.01 | 0 |
| 16. | Partia për Prosperitet Demokratik– PPD | 277 | 0.02 | 0 |
| 17. | Rilindja Demokratike Kombëtare – RDK | 29,996 | 2.67 | 2 |
| 18. | Të Bashkuar për Maqedoninë – BM | 17,081 | 1.52 | 0 |

- 1,156,049 njerëz votuan dhe pjesëmarrja në zgjedhje ishte 63.48 për qind.
- Ka pasur 1,124,064 fletë votimi të vlefshme dhe 31,985 të pavlefshme.
- Për votimin jashtë vendit (d.m.th. në njësitë zgjedhore shtatë, tetë dhe nëntë) ka pasur 7,213 zgjedhës të regjistruar nga të cilët votuan 4,088 dhe pjesëmarrja ishte 56.67 për qind.
- Në njësitë zgjedhore shtatë, tetë dhe nëntë, ka pasur 3,972 fletë votimi të vlefshme dhe 116 të pavlefshme.
- Të tre mandatet nga njësitë zgjedhore shtatë, tetë dhe nëntë i takuan koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-së.

[Burimi: Ueb faqja e KSHZ-së (<http://217.16.84.11/Default.aspx>)]

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992). Kjo pjesë është edhe dimensionin human i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë, në të cilin të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, për këtë organizatë të punojnë mbi 130 vetë.

OSBE/ODIHR-i është organizmi kryesor në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me angazhimet ndaj OSBE-së, standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e vet unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat e mëposhtme tematike: sundimin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton një numër programesh asistence çdo vit, duke kërkuar të zhvillojë strukturat demokratike.

Po ashtu, OSBE/ODIHR-i mbështet shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e ekspertizës në fusha si të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, monitorimi i të drejtave të njeriut dhe raportimi mbi to, si edhe të drejtat e njeriu të grave dhe siguria.

Për fushën e **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i i jep mbështetje shteteve pjesëmarrëse për të forcuar përgjigjet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-Semitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Veprimtaritë e OSBE/ODIHR-it në këto fusha përqendrohen në tematikat e mëposhtme: legjislacioni, trajnimi për zbatimin e ligjit, monitorimi i përgjigjes që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si edhe raportimi mbi to dhe vëzhgimi i mëtejshëm i tyre, por edhe aktivitete edukative për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **rome** dhe **sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve Romë dhe Sinti në organet politikëbërëse.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it në www.osce.org/odihr.